



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 406/2014

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha, dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Valon Ramadani nga subjekti politik Nisma për Kosovën, dega në Ferizaj, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me dt. 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

#### VENDIM

- I. Miratohet** si e bazuar ankesa e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Valon Ramadani nga subjekti politik Nisma për Kosovën, dega në Ferizaj.
- II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ti rinumëroi vetëm fletëvotimet për kandidatët e subjektit politik Nisma në Vendvotimin (VV) 2505D/06D.
- III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutisë së votimit të VV si në pikën II të këtij diapozitivi, të përfshihet në rezultatit përfundimtar.

#### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.06.2014, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Valon Ramadani, nga radhët e subjekti politik Nisma dega në Ferizaj, me të cilën pretendohet se gjatë plotësimit të FRK-së nga ana e kryesuesit të VV 2505D/06D, ka anashkaluar votat e tij nga pakujdesia apo nga qëllime tjera, duke mos proceduar gjithsej 3 vota.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmisë ka ofruar deklaratën e komisionerit të VV 2505D/06D Flamur Rekaj.

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i “Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme “

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri administrimin e materialit zgjedhor konstatoi se:

### **ankesa është e bazuar**

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga kandidati Valon Ramadani nga subjekti politik Nisma në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e hetimeve të fletëvotimeve për të cilat kandidati në fjalë pretendon në ankesën e tij se është dëmtuar nga mos procedimi i 3 votave në FRK nga ana e Kryesuesit të VV 2505D/06D.

Nga ekipi i PZAP-it është konstatuar se kutia e votimit me nr. 2505D/06D për Komunën e Ferizajt ishte e mbyllur prej 4 shiritave anësorë të sigurisë dhe një shiriti në mes të kutisë. Shiritat anësor të kutisë kanë nr. 095905, 095902, 095903 dhe 095904 ndërsa shiriti i mesëm nr. 095877 i cili nuk ishte i prekur fare

Në vazhden e hetimit, ekipi i PZAP-it ka konstatuar se nga origjinali i FRK-së që gjendet në QNR, kandidati me nr 55 nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën nuk posedon asnjë votë, ndërsa pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutinë e votimit 2505D/06D del se janë 3 fletëvotime të vlefshme të kandidatit në fjalë. Pas përfundimit të hetimit thesi brenda kutisë ishte mbyllur me shiritin e sigurisë me nr.076788 dhe mbyllja e kutisë me shiritat të sigurisë si 076787, 076785, dhe 076784.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe nga deklaratat e vëzhguesit del se kandidati me nr 55 ka poseduar 3 vota dhe nga hetimet e bëra del se ka pasur një lëshim gjatë plotësimit të FRK-së në VV e cekur më lartë, me ç'rast numri i 3 votave të kandidatit Valon Ramadani nuk ishin përfshirë në rezultatet përfundimtare të shpallura nga ana e KQZ-së.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, 117.4 dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë**

Anr. 406/2014 më datën 30.06.2014



#### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*